



KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA TRYEZA E MBAJTUR
MË DATËN 15 NËNTOR 2005

PRISHTINË, 2005

Në tryezë u trajtuan këto tri çështje madhore të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti:

1. Raport për shkrimet e shkruara për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës në shtypin e përditshëm të shkruar në Kosovë për vitin 2004
2. Analizë e gjendjes së të drejtave të fëmijëve që kanë rënë në konflikt me ligjin - shkaqet dhe pasojat
3. Pse duhet hartuar Strategjia nacionale për fëmijët e Kosovës

Në tryezë kanë marrë pjesë ekspertë për të drejtat e njeriut, përfaqësuesit e Këshillit për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, përfaqësuesit e Shtëpisë Korrektuese për Fëmijë në Lipjan, përfaqësuesit e mediave të shtypura dhe elektronike, përfaqësuesit e qendrave sociale, përfaqësuesit e ministrive të Qeverisë së Kosovës (Ministritë së Arsimit, Ministritë së Shëndetësisë, Ministritë së Mjedisit, Ministritë për Punë dhe Çështje Sociale), përfaqësuesi e Trocair-it, z. Frenk Gynor, përfaqësuesit e Shërbimit Policor të Kosovës, përfaqësuesit e Organizatave joqeveritare të Kosovës etj.

Pas fjalëve hyrëse dhe diskutimeve të bëra, doli konkluzioni se me gjithë përparimet e bëra të pakontestueshme në fushën të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë nga viti 1999 e këndej, gjendja e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës ende është shumë larg nga nevojat reale të qytetarëve të Kosovës, standardet dhe e drejta ndërkombëtare. Kjo gjendje inkompatibile me standardet e me të drejtën ndërkombëtare dhe me nevojat reale të qytetarëve të Kosovës për të jetuar në një shtet ligjor - ku veprojnë ligjet demokratike me të cilat sigurohet dhe garantohet liria e të gjithë qytetarëve, barazia para ligjit dhe në jetën praktike, ku ekzistojnë dhe veprojnë instrumentet dhe mekanizmat funksionalë për mbrotjtjen dhe përkujdesjen sociale shëndetësore, për lëvizjen e lirë të tyre, për sigurimin e ambientit të shëndoshë, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, kulturor dhe arsimor - është e kushtëzuar nga një mori faktorësh objektiv dhe subjektiv.

Nder faktorët objektiv, në tryezë u veçuan: gjendja e pavolitshme e drejtave të njeriut e trashëguar nga e kaluara, pasojat e luftës me të gjitha ndikimet e saj në shëndetin mental, gjendja ekonomike, arsimore e shëndetësore, varfëria, papunësia, statusi i pazgjidhur politik i Kosovës, etj.

Në këtë gjendje të pavolitshme pos faktorëve objektiv ka ndikuar edhe një numër faktorësh subjektiv: përkushtimi i pamjaftueshëm i mediave, mos kooperimi i mjaftueshëm dhe i suksesshëm i organeve dhe i organizatave qeveritare dhe joqeveritare, krimi i organizuar, lidhja e disa segmenteve të pushtetit me krimin e organizuar, cilësia jo e mirë e punës edukative dhe arsimore në sistemin e arsimit, pozita edhe statusi jo i mirë i punëtorëve të arsimit.

Mendim unanim i të gjithë pjesëmarrësve në tryezë ishte se edhe në kushtet dhe në rrethanat e tashme gjendja e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës mund të avancohen shumë nëse bëhen tri gjëra kryesore:

- a. Mediat e shtypura dhe elektronike angazhohen më shumë dhe më me kreacion në fushën e promovimit dhe të fuqizimit të drejtave të njeriut
- b. Nëse merren një sërë masash për parandalimin, risocializimin, ri-integrimin e fëmijëve të përfshirë në delikuecën e të miturve

c. Nëse hartohet një strategji nacionale gjithëpërfshirëse, dhe e zbatueshme për fëmijët e Kosovës

Kështu, për marrjen e masave të sipërpërmendura, nga pjesëmarrësit në tryezë u miratuan disa rekomandime:

A. REKOMANDIMET LIDHUR ME MEDIAT

- ✚ Të shtohet numri i punimeve në gazeta lidhur me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, ndërsa në media elektronike për disa herë të shtohet numri i emisioneve kushtuar të drejtave të njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Në shkolla dhe fakultete të gazetarisë të futet lënda: Të drejtat e njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Për gazetarët të organizohen trajnime sistematike për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës. Brenda vitit 2006 të organizohet një trajnim 5 ditorë për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës. Ky trajnim të organizohet nga OSBE
- ✚ Redaksitë e gazetave të përpilojnë politika strategjike që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës. Secila gazetë, radio apo shtëpi televizive së paku njëherë në muaj të organizojë një tryezë, tribunë apo debat publik për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë
- ✚ Të stimulohen qasjet kreative, hulumtuese dhe proaktive në gazetari. Në politikat redaktuese punimet hulumtuese dhe me qasje proaktive të stimulohen më shumë se sa punimet me karakter informativ
- ✚ Secila nga mediat e shkruara dhe elektronike të përcaktojnë një gazetar që do të jetë përgjegjës për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Të organizohen trajnime të veçanta për gazetari hulumtuese në bashkëpunim me OSBE-në
- ✚ Të garantohet dhe të sigurohet liria e plotë e gazetarëve me ligje dhe me masa tjera parandaluese.

B. REKOMANDIME PËR PARANADALIMIN E DELIKUENCËS SË MITURËVE

Delikuenca e të miturve është një ndër problemet e mëdha të shoqërisë kosovare. Statistikat tregojnë se ky fenomen është në rritje e sipër. Arsyet janë të shumta. Delikuenca e të miturve është pasojë e mosfunksionimit të duhur, qoftë në relacionet fëmijë-familje-mjedis-shkollë, qoftë nga në relacionin e fëmijës me njërën nga elementet e sipërpërmendura. Në delikuencën e të miturve ndikim të madh ka mënyra e funksionimit të sistemit të arsimit.

Me qëllim të parandalimit të delikuencës së miturve duhet marrë këto masa:

- ✚ Të respektohen të drejtat e fëmijëve në shkolla
- ✚ Në secilën shkollë të mbahen statistika të sakta për fëmijët që kanë vështirësi në nxënie, që kanë sjellje asociale, që tregojnë shenja të agresivitetit, mungesës së interesimit për mësim, që nuk i vijojnë mësimet me rregull, që vonohen, që i braktisin orët e mësimi, që janë hiper apo hipo aktiv, që kanë vëmendjen e shkapërderdhur, që kanë fobi nga shkolla, që belbëzojnë, që tregojnë shenja stresi dhe ankthi, që nuk kanë shprehur higjienike, që nuk i kryejnë obligimet shkollore, fëmijët jetim, fëmijët e prindërve të shkurorëzuar etj.

- ✚ Fëmijët e këtyllë të kategorizohen në bazë të paradigmave dhe modeleve që do të përgatiten nga Ministria e Arsimit, Qendrat Sociale, Ministria e Shëndetësisë etj
- ✚ Shkollat për fëmijët e këtyllë të hartojnë programe të veçanta edukimi, ndihme dhe të përkrahjes
- ✚ Në shkolla të kthehen pedagogët e shkollave dhe të forcohen shërbimet këshillëdhënëse duke instaluar shërbimet sociale, psikologjike, logopedike dhe të higjienës mentale
- ✚ Të hartohen programe të partneritetit të shkollave me komunitetin, me familjet, shërbimet e ndryshme specializuese etj.
- ✚ Të hartohen programe të veçanta të bashkëpunimit të shkollave me SHPK-në, me qendrat për punë sociale dhe me OJQ-të
- ✚ Të krijohen lehtësi për këshilltarët për të drejtat e fëmijës
- ✚ Të formohen parlamentet shkollore si dhe komitetet për mbrojtjen e të drejtave dhe të fëmijës
- ✚ Në shkolla të formohen dosje të veçanta për fëmijë të cilët punojnë punë që janë në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës
- ✚ Në shkolla të vendoset “ Kutia për të drejtat e fëmijës”
- ✚ Në Kuvendin e Kosovës të ratifikohet Deklarata Botërore për Mbijetesën, Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve (dhe të përkthehet në gjuhën turke (në gjuhën shqipe dhe serbe është përkthyer nga KEC))
- ✚ Të miratohet nga Qeveria e Kosovës: Plani i veprimit për zbatimin e Deklaratës mbi Mbijetesë, Mbrojtje dhe Zhvillim të Fëmijëve (Një model i Planit është publikuar në librin Të Drejtat e Fëmijës¹)
- ✚ Të rishikohet infrastruktura juridike lidhur me fëmijët që kanë ra në konflikt me ligjin, me qëllim të humanizimit të tyre të mëtejme.
- ✚ Ministria e Arsimit dhe Ministria për Punë dhe Çështje Sociale të hartojnë programe arsimimi dhe aftësimi për fëmijët në shtëpitë korrektuese, si dhe t’iu pranohen: diplomat, licencat, dëftesat etj
- ✚ Të hartohen programe bashkëpunimi të njëjësive ndërministrorë me Shtëpinë Korrektuese
- ✚ Para daljes nga Shtëpia Korrektuese për secilin fëmijë veç e veç të hartohet programi për pranimin e tij/saj në shoqëri, ri-integrim në jetën normale dhe përkrahjen e tij/saj për t’u bërë pjesëtar aktiv i shoqërisë.

C. REKOMANDIME PËR HARTIMIN E STRATEGJISË NACIONALE TË FËMIJËVE TË KOSOVËS

Hartimi i Strategjisë nacionale për të drejtat e fëmijës është domosdoshmëri për arritjen e standardeve ndërkombëtare. Vetë strategjia është element i domosdoshëm i pakos ndërkombëtare të treguesve të gjendjes së drejtave të fëmijës. Strategjia duhet të hartohet për periudhën 2007 – 2017. Kjo duhet të hartohet në përputhje me parimet e Bashkësisë Evropiane. Duhet të jetë gjithëpërfshirëse (në hartimin saj duhet të marrin pjesë të gjithë faktorët relevantë: organet e pushtetit, organet legislative,

¹ Qendra për Arsim e Kosovës (2004) Të drejtat e fëmijës. Manual për drejtat e njeriut dhe të fëmijës, f. 203 -208

ekzekutive, të gjitha ministritë e Qeverisë së Kosovës, OJQ-të, ekspertët ndërkombëtarë etj.

Me Strategji duhet të mundësohet të krijohet një: SHOQËRI MIQËSORE për të gjithë fëmijët e Kosovës.

Për hartimin e strategjisë rekomandohet:

- ✚ Të formohet Këshilli nacional për hartimin e strategjisë i cili përbëhet nga të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë kosovare²
- ✚ Të hartohet Komiteti për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së drejtave të fëmijës
- ✚ Të bëhet ekspertiza e gjendjes së të drejtave (deri më 31 janar 2006)
- ✚ Të hartohet versioni i parë i strategjisë
- ✚ Të përgatitet konferenca ndërkombëtare: Strategjia nacionale e Fëmijëve të Kosovës (deri më 30 korrik 2006)
- ✚ Të mbahet konferenca ndërkombëtare në temën: Zhvillimi dhe promovimi i të drejtave të fëmijës në Kosovë 2007-2017
- ✚ Të miratimi strategjia në Kuvendin e Kosovës (tetor 2006)
- ✚ Të hartohen planet e veprimt - deri më datën 31 dhjetor 2006

² Shih: Projekt – draftin për hartimin e Strategjisë nacionale www.childrights-ks.org